



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSA STUDIMI NË BACHELOR, MASTER DHE PhD
TË OFRUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS SË UKRAINËS**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Ukrainës, me anë të Ambasadës së Ukrainës në Shqipëri informon se në vijim të marrëveshjes midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Ukrainës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, pala ukrainase ofron 5 (pesë) bursa shtetërore për shtetasit shqiptarë, për vitin akademik 2024/2025. Afati i dorëzimit të dokumentacionit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është deri më datë 29 shkurt 2024. Dokumentat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën angleze dhe të noterizuara. Bursat janë në fushën e shkencave humane, shkenca sociale dhe shkenca teknike, përkatësisht 4 (katër) bursa në nivelin Bachelor dhe Master dhe 1 (një) bursë në nivelin PhD. Gjuha e studimeve do të jetë gjuha ukrainase.

Bashkëlidhur gjendet formati i aplikimit dhe informacion i detajuar mbi bursat e ofruara.